

Dardha, një vend I pandryshueshem natyror që të lë pa fjalë

Përmbledhje

Do ta nisni ekskursionin në hyrje të fshatit. Shenja që do të ndiqni është « e bardhë-e kuqe-e bardhë ». Do të përshkoni një udhë 1.4 km, të gjerë dhe të thjeshtë për t'u kaluar, për të arritur në fund në një livadh. Këtu përfundon dhe eskursioni juaj. Për t'u kthyer në Dardhë, do t'iu duhet të ktheheni nga e njëjta rrugë.

Në këtë shëtitje, do të zbuloni disa nga karakteristikat e bukura të një fshati shqiptar, dhe natyrën e saj magjepsëse.

Pika e nisjes është midis shkollës së fshatit, kishës Shën Gjergji dhe bashkisë, ndërtimi I së cilës daton në vitin 1936. Pranë saj gjendet një hartë e Dardhës me përshkrimin e fshatit.

Udhëtimi juaj nis duke ndjekur rrugën « Koço Gliozhemi », duke ndjekur shenjen 'e bardhë – e kuqe – e bardhë'. Rruga është e gjerë. Në të majtën tuaj, ju mund të shihni shtëpi tradicionale shqiptare, me arkitekture tipike dardhare: janë shtëpi njëkatëshe të ndërtura me gurrë. Në njëra prej tyre, rreth 45 m nga nisja, mund të shijoni lakronin, një lloj byreku.

Pas rreth 160 metrash, do të arrini në një kryqëzim me tre udhë: merrni rrugën në të majtë, duke ndjekur shenjat. Rruga është më e ngushtë dhe pak e tatëpjetë. Në fund të zbritjes, mund të shihni një varrezë ortodokse dhe do të mund të shuani etjen të burimi I ujit « Kroi i Qatos ». Do të ndiqni rrugën në të djathtë. Duke zbritur, mund të dëgjoni zhurmën e përroit në të majtën tuaj. Rruga ngjitet pak. Do të kaloni para një restoranti të këndshëm, buzë lumit.

Në kryqëzim, do të ktheheni në të majtë, do të kaloni lumin dhe të do të ktheheni përsëri në të majtë duke ndjekur shenjat. Shtegu, që ngjitet, I thyer e me gropa të vogla, është i vështirë për tu kaluar.

Pasi keni lënë pas shtëgun, mund të shihni rrugën e përshkruar. Pak më larg, do të kapërceni rrëkenë që përshkon rrugën. Prurja e kësaj rrekeje ndryshon në varësi të stinëve. Në këtë vend, mund të dalloni një ndryshim të vegjetacionit.

Duke dalë nga pylli, do të merrni rrugën në të djathtë. Kjo rrugë është më e lehtë për t'u kaluar se ajo në të majtë, drejt së cilës na drejtojnë dhe shenjat. Në pikën më të lartë të ngjitjes, do të gjendeni në një shesh. Ky është dhe fundi I eskursionit tuaj. Nëse shkoni këtu në verë, do të keni mundësi të nuhatni aromën e këndshme të rigonit.

Nëse keni dëshirë, jeni të lirë të vazhdoni rrugën deri në kisha Shën Pjetër.

Për të shkuar në Dardhë ka dy mundësi. Ju mund të merrni furgon ose taksi. Ju mund të gjeni taksi pranë Grand Hotel. Ju mund të negocioni për çmimin por taksia kushton më shtrenjte. Ju mund të gjeni furgonin gjithashtu ngjitur grand hotel. Nëse jo, ju mund të kontaktoni një shofer taksie me dashamirësinë e nënpunësve të Aleancës Franceze të Korçës, e cila gjendet pranë bashkisë. Furgoni kushton 400 lek për person vajtje-ardhje. Udhëtimi zgjat rreth 45 minuta. Furgoni do t'ju lerë në hotel Dardha. Ju do të filloni të ecni deri në bashkia e fshatit. Atëherë është koha të filloni shëtitjen !